



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR.6, QARKU SHKODËR,  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 08.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.6, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1, e ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1559 prot., datë 20.03.00.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Shkodër, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Shkodër që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për tetë (8) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr.2590 prot, datë 30.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për seicilën nga VNV-të e Qarkut Shkodër.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr.6, Qarku Shkodër, është:



**Nr. 263 i Vendimit    Data 08.05.2019 e Vendimit    Ora 10:00 e Vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.06, Qarku Shkodër,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

1. Palestra e Shkollës së Mesme Profesionale "Ndre Mjeda", me sipërfaqe mbi 300 m2;

Ambienti i propozuar ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e mëparshme, ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.6, Qarku Shkodër, në Palestrën e Shkollës së Mesme Profesionale "Ndre Mjeda", me sipërfaqe mbi 300 m2, Bashkia Vau Dejës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 263 i Vendimit    Data 08.05.2019 e Vendimit    Ora 10:00 e Vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.06, Qarku Shkodër,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019